

# CANADA'S COVID-19 ECONOMIC RESPONSE PLAN



## Mbështetje për Individët

Plani Federal për Mbështetjen Qeveritare përfshin mbështetje për individët në formën e rritjes së përfitimeve për fëmijët, kredi tatimore për mallra dhe shërbime (një herë), shtyrja e dorëzimit të tatimit mbi të ardhurat, dhe mbështetje hipotekare.

Për më shumë informacion, vizitoni: [Canada's Economic Response Plan](#)

### Rritja e Përfitimeve për Fëmijët

Një shtesë \$300 për fëmijë nepermjet programit të Përfitimeve për Fëmijët (Canada Child Benefit - CCB) për 2019-20. Kjo do të thotë rreth 550 \$ më shumë për një familje mesatare. Ky përfitim do të jepet si pjesë e pagesës të planifikuar nga CCB në Maj.

**Ata që tashmë marrin Përfitimeve për Fëmijët nuk kanë nevojë të ri-aplikojnë.**

### Pagesa speciale kredie për mallrat dhe shërbimet

Një pagesë speciale (një herë) deri në fillim të Majit përmes kredisë tatimore të mallrave dhe shërbimeve për familjet me të ardhura të ulëta dhe modeste. Përfitimi mesatar shtesë do të jetë afër \$400 dollarë për individë beqarë dhe afër \$600 dollarë për çifte.

**Nuk ka nevojë për të aplikuar për këtë pagesë. Nëse plotëson kushtet, ju do të merrni atë automatikisht**

### Kohë shtesë për dorëzimin e tatimit mbi të ardhurat

Data për dorëzimin e taksës mbi të ardhurat për 2019, shtyhet deri në 1 Qershor, 2020. Detyrimet apo këstet shtyhen deri në Gusht 31, 2020 pa interes apo gjob.

### Mbështetje hipotekare (pronësi)

Bankat kanadeze janë angazhuar të punojnë me klientët e tyre rast pas rasti për të gjetur zgjidhje për t'i ndihmuar ata të menaxhojnë vështirësitë e shkaktuara nga COVID-19.

Kanadezët të ndikuar nga COVID-19 dhe që po përjetojnë vështirësi financiare si rezultat duhet të kontaktojnë institucionin e tyre financiar në lidhje me fleksibilitetin për një shtyrje të pageses hipotekare. Kjo lejon për fleksibilitet - kur është e nevojshme - për ata që kanë më shumë nevojë.

### Mbështetje për njerëz që përballen me papunësinë, nuk janë në gjendje të punojnë, apo që janë të sëmurë, në karantinë, ose në regjim vetë-izolimi

Canada Emergency Response Benefit (CERB) do të sigurojë një përfitim të tatueshëm prej 2.000 \$ në muaj për deri në 4 muaj për:

- Punonjësit të cilët duhet të ndërpresin punën për shkak të COVID19 dhe nuk përfitojnë leje të paguar ose mbështetje tjetër në të ardhura.
- Punonjësit të cilët janë të sëmurë, në karantinë, ose duke u kujdesur për dikë që është i sëmurë me COVID-19.
- Prindërit që punojnë të cilët duhet të qëndrojnë në shtëpi pa paguar për t'u kujdesur për fëmijët që janë të sëmurë ose kanë nevojë për kujdes shtesë për shkak të shkollës dhe mbylljes së çerdheve.
- Punonjësit të cilët ende janë të punësuar, por nuk janë duke u paguar, sepse nuk ka për momentin punë të mjaftueshme dhe punëdhënësi i tyre ka kërkuar të mos vijnë në punë.
- Rrogetareve dhe individët e vetëpunësuar, përfshirë punëtorët me kontrat, të cilët nuk përfitojnë nga Sigurimi Punësimit (Employment Insurance).

Nëse jeni të sëmurë, në karantinë ose u është kërkuar të vetë-izoloheni, qeveria nuk do t'ju kërkojë certifikatë mjekësore si kusht përfitimi për sëmundjen nga Sigurimi Punësimit.

**CERB do të jetë i mundshëm përmes një portali në fillim të prillit. Aplikantët do të jetë në gjendje të aplikojnë nëpërmjet një linjë telefonike të automatizuar ose nëpërmjet një numri falas.**

### Mbështetje për të moshuarit.

Ulje të tërheqjeve minimale për fondet e regjistruara të të ardhurave të pensionit (RRIFs) me 25% për vitin 2020.

### Mbështetje për studentët dhe të diplomuarit e fundit.

Një moratorium pa interes pa afat, që fillon në 30 Mars, për shlyerjen e kredive studentore në Kanada për të gjithë huamarrësit e huasë studentore. Nuk do të kërkohet pagesa dhe interesi nuk do të grumbullohet gjatë kësaj kohe.

**Studentët nuk kanë nevojë të aplikojnë për pauzë shlyerjes.**